



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 42 , Datë 01/06/2017

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mbështetur në nenin 32, pika 1, germa c), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, bazuar në Urdhrin nr. 161, datë 27.09.2016, filloi procedurën e shqyrtimit “ex-officio” të çështjes së refuzimit të regjistrimit të 18 vjeçarit D.S., në Liceun Artistik “Jordan Misja” në Tiranë, për shkak se vuan nga çrregullime të spektrit autik.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Komisioneri,

K O N S T A T O N:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Më datën 16 shtator 2016, gazeta “Shqiptarja.com” ka publikuar shkrimin me titull: “*Djali autik gjeni pikturë, por nuk e regjistrojnë në shkollë*”, i cili i referohej refuzimit të regjistrimit të djalit 18 vjeçar D.S., në Liceun Artistik “Jordan Misja” në Tiranë, për shkak të çrregullimit të spektrit autik.

Më datën 27 shtator 2016, po kjo gazetë ka nxjerrë një tjetër shkrim me titullin: “*Piktori autik diskriminohet në konkursin e Liceut*”, ku citohet se: “*18 vjeçari Drini Sollaku nuk pranohet në Liceun Artistik “Jordan Misja” edhe pse ligji ia jep këtë të drejtë, pa iu nënshtruar konkursit*”.

Referuar informacionit të publikuar, “*Drini Sollaku është paraqitur në konkursin e pikturës me shpresën për të ndjekur Liceun Artistik dhe nuk është pranuar nga drejtoria e institucionit që ta regjistrojë. Nëna e 18 vjeçarit, E.S. ka deklaruar se i biri ka mbaruar shkollën 9 vjeçare “Mihal Grameno” në Tiranë me nota kaluese dhe për shkak të talentit në pikturë ai dëshiron të vazhdojë studimet në Liceun Artistik “Jordan Misja”*”. Sipas saj, “*janë shkelur të gjitha ligjet për arsimin e*

kufizuar në përgjithësi. Djali im u ndje i diskriminuar, sepse atij po i mohohet e drejta e arsimit special në fushën e artit”.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Komisioneri duke pasur në vëmendje se veprime të tilla mund të përbëjnë objekt të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, mbështetur në tagrat e dhëna prej tij, konkretisht neni 32, pika 1, gërma c): “Komisioneri ka kompetencë të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji”, vendosi ndjekjen e çështjes kryesisht, bazuar në Urdhërin nr. 161, datë 27.09.2016 “Për fillimin e procedurave për ndjekjen “ex officio” të çështjes së refuzimit të regjistrimit të djalit autik D. S., në Liceun Artistik “Jordan Misja” në Tiranë”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri ndërmori hapat e mëposhtëm:

Më datën 06.10.2016 Komisioneri ftoi në takim znj. E. S., nëna e 18 vjeçarit D.S., e cila është dhe kujdestare ligjore e djalit të saj. Ajo ra dakord që kjo çështje të ndiqej kryesisht, nga Komisioneri¹.

Përmes shkresës nr. 890/1 prot, datë 10.10.2016, drejtuar Komisionerit, organizata “Shërbimi Ligjor Falas”² ka vënë në dispozicion aktet e mëposhtme:

- Kopje e pasaportës, Nr. BC7327949 e D.S., i datëlindjes 04.01.1998.
- Vërtetim nr. 4837, datë 12.11.2013 i KMCAP për D.S., “I cili vuan nga autizmi dhe ka nevojë për kujdes të vazhdueshëm të familjarit”.
- Shkresë e datës 09.09.2016, e Shërbimit Ligjor Falas Tiranë, drejtuar Ministres së Arsimit, znj. Lindita Nikolla: “Kërkesë për miratim për të drejtën për arsim për një nxënës me aftësi të kufizuar në Liceun Artistik “Jordan Misja”, Tiranë”.
- Shkresën nr. 4124 Prot, datë 20.09.2016, e Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë, drejtuar shkollës artistike “Jordan Misja” Tiranë “Marrje masash” për hapjen e procedurave të konkurrimit për nxënësin D.S..
- Shkresë, “Kërkesë për informacion”, datë 26.09.2016, e Shërbimit Ligjor Falas TLAS,
- Shkresë nr. 4067/1 prot, datë 26.09.2016, e Shkollës së Mesme Artistike “Jordan Misja”. Kthim përgjigjes znj. Edlira D.S..

¹ Takimi u reflektua në procesverbalin e mbajtur në këtë takim, i cili pasi u lexua nga palët e pranishme, u nënshkrua prej tyre, në çdo fletë të tij¹. Procesverbali u mbajt në 2 (dy) kopje, njëra prej të cilave iu dorëzua subjektit të thirrur në takim.

² Organizata “Shërbimi Ligjor Falas”, ka përfaqësuar znj. D.S., në gjykatë.

- Shkresë nr. 31 prot, datë 04.10.2015, “Kthim Përgjigje”, znj. E. S.,
- Dëftesë lirimi e nxënësit D.S., Nr. 619941, Nr. Amze 2324, Nr. Regjistri 3463, lëshuar nga shkolla 9 vjecare “Mihal Grameno”.
- Certifikatë për pjesëmarrje në seminar të D.S.t, datë 16 prill 2016.
- Katalog pikturash të nxënësit D.S.
- Katalog pikturash “Challenge”, Exhibition 12, me punime të 9 (nëntë) piktorëve, ndër ta edhe D.S., ekspozuar në Galerinë Kalo, 17 maj-12 qershor 2016, me mbështetjen e Ambasadës Gjermane në Tiranë.

Për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, me shkresë nr. 890/2 prot, datë 10.10.2016, Komisioneri iu drejtua për informacion Drejtorisë së Liceut Artistik “Jordan Misja”, Tiranë dhe për dijeni Drejtorisë së Arsimit Parauniversitar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit si dhe Drejtorisë Arsimore Rajonale, Tiranë.

- Me shkresë nr. 67/1 prot, datë 11.11.2016, Shkolla Artistike “Jordan Misja” informon se “Në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të Udhëzimit Nr. 14, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, datë 12.05.2015 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pranimin në shkollat e arsimit të orientuar”, shkolla artistike “Jordan Misja”, Tiranë është një shkollë ku pranimet e nxënësve bëhen vetëm nëpërmjet procedurave të konkursit, për cdo profil (pikturë, piano, violinë, violincel etj)”.

- Me shkresë nr. 4679/1 prot, datë 20.10.2016, Drejtoria Arsimore Rajonale e Qytetit të Tiranës, bën me dije se “Nisur nga fakti që nxënësi D.S. është me aftësi të kufizuara, DAR Tiranë ka urdhëruar shkollën, përmes shkresës nr. 4124, datë 20.09.2016, që të rihap procedurat e konkurrimit për t’i dhënë mundësi nxënësve me AK që t’i nënshtroheshin konkurrimit. Nga konkursi i datës 26.09.2016, mbështetur në vlerësimet e punimeve nga komisioni, nxënësi D.S. ka marrë 0 (zero) pikë. Sipas DAR Tiranë, ky është shkaku i mosregjistrimit të tij pranë kësaj shkolle”. DAR Tiranë ka depozituar në cilësinë e provës aktet e mëposhtme:

- Shkresën nr. 4124 Prot, datë 20.09.2016, drejtuar shkollës artistike “Jordan Misja” Tiranë për hapjen e procedurave të konkurrimit për nxënësin D.S..
- Shkresë nr. 4067/1 prot, datë 26.09.2016, Kthim përgjigje znj. Edlira D.S., lidhur me çeljen e procedurës së konkurrimit për djalëin e saj.
- Shkresë nr. 25 prot, datë 23.09.2016 “Vendim Drejtorie”, për ngritjen e Komisionit të Konkursit të Klasës 10-të për vitin mësimor 2016-2017.
- Proceverbali i zhvillimit të konkursit (D.S. vlerësuar me zero pikë).

Në vijim të procedurave të shqyrtimit të çështjes, në zbatim të Urdhrit nr. 179, datë 14.11.2016, Inspektorë të Komisionerit zhvilluan inspektim pranë Liceut Artistik “Jordan Misja”, ku u takuan me Drejtoreshën e institucionit znj. V. G.

- Referuar procesverbalit të inspektimit dhe akteve të administruara, rezulton se nxënësi “D.S., i është nënshtruar konkursit së bashku me 2 nxënës të tjerë, më aftësi të kufizuar”³, në zbatim të aktit nr. 4124 prot, datë 20.09. 2016, të Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qytetit të Tiranës.
- Në zbatim të Udhëzimi Nr. 14, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, datë 12.05.2015 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pranimin në shkollat e arsimit të orientuar”⁴, me shkresë nr. 25 prot, datë 23.09.2016, “Vendim drejtorie nr. 12” të Drejtores së Liceut, znj. Valbona Gavelli, më datën 26.09.2016 u zhvillua konkursi për nxënësit: D.S.; E. B. dhe Sh. S., në prezencë të Komisionit të përbërë nga 5 (pesë) mësues. Nga proceverbali i mbajtur rezulton që nxënësi D.S. është vlerësuar me 0 (zero) pikë, ndërsa nxënëset E. B. dhe Sh. S. janë vlerësuar me 1 (një) pikë.
- Lidhur me pretendimet e znj. E.S., nëna e D.S., se dy nxënëset e tjera janë pranuar të ndjekin studimet pranë Liceut Artistik, ndërsa djali i saj nuk është pranuar, znj. V. G. ka sqaruar se “Nga konkursi askush nga fëmijët nuk ka fituar. Më pas përmes një akti të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, dy vajzat janë pranuar të ndjekin studimet pranë këtij liceu”.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka patur në vëmendje vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Gjatë procesit të hetimit dhe shqyrtimit të akteve, Komisioneri konstatoi:

Ligji 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikon një listë joshteruese shkaqesh për të cilat ofron mbrojtje, ndër to edhe aftësia e kufizuar, parashikuar në nenin 1 të tij: *“Objekti i këtij ligji është të rregullojë zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Legjislacioni në fushën e arsimit synon t’i jap përparësi trajtimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, në institucionet arsimore shqiptare. Në nenin 64, pika 1, e ligjit nr. 69/2012 “Për

³ Dy nxënëset E. B. dhe Sh. S., që iu nënshtruan konkursit bashkë me nxënësin D.S., janë me aftësi të kufizuara në dëgjim dhe shikim.

⁴ Udhëzimi Nr. 14, Kreu 3: “Pranimet me konkurs”, pika 1, citon shprehimisht: “Në shkollat artistike dhe sportive, nxënësit pranohen me konkurs”.

sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” citohet se: *“Nxënësve me aftësi të kufizuara u sigurohet arsimimi në shkollat e arsimit të mesëm e të lartë, sipas kritereve të miratuara nga Ministri e Arsimit dhe Ministri i Shëndetësisë”.*

Në pikën 1 të Kreut 3 të Udhëzimit Nr. 14, datë 12.05.2015 “Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për pranimin në shkollat e arsimit të orientuar” këtij udhëzimi, parashikohet shprehimisht: *“Në shkollat artistike dhe sportive, nxënësit pranohen me konkurs”,* çfarë do të thotë se konkurrimit për pranim në këto shkolla i nënshtrohen të gjithë kandidatët pjesëmarrës, pa asnjë dallim. Vihet re qartë se, në asnjë dispozitë tjetër të këtij akti nuk parashikohen kritere të tjera, në mbështetje të nxënësve të kësaj kategorie.

Në rastin konkret, nxënësi D.S., i cili i përket grupit të personave me aftësi të kufizuara i është nënshtruar konkurrimit njëloj si nxënësit e tjerë edhe pse kondicioni fizik i tij, nuk është i njëjtë. Fakti që Drejtoria Arsimore e Tiranës ka urdhëruar rihapjen e testimit për tre nxënës me aftësi të kufizuara, ndër to edhe D.S.t, ka synuar në dukje ndreqjen e situatës, por kriteret e pranimin dhe nënshtrimit të konkursit mbetëm po ato edhe pse jemi përballë një rasti të veçantë, ku ligji detyron institucionet që të bëjnë rregullime të domosdoshme, në përshtatje të nevojave të këtyre individëve.

Sa më sipër, referuar Konventës Europiane të Drejtave të Njeriut, e cila është pjesë e legjislacionit të brendshëm dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ⁵, konkretisht Vendimit për çështjen *“Thlimmenos kundër Greqisë”*⁶, ndër të tjera citohet: *“..... Kemi diskriminim kur shteti, pa një argumentim objektiv dhe racional, e refuzon trajtimin e diferencuar të personave, situata e të cilëve është tepër e ndryshme.....”.*

Ky vendim, i kësaj Gjykate, është shembulli më i qartë i trajtimit të diferencuar të personave të cilët për shkak të kushteve të ndryshme, nuk mund të trajtohen njëloj me të tjerët.

Mbështetur në frymën e legjislacionit evropian dhe të legjislacionit të brendshëm, konkretisht të parimeve bazë të ligji nr. 93/2014, “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”⁷, neni 4, pikat ç) dhe ë) të tij:

ç) *garantimi i aksesueshmërisë nëpërmjet mënjanimit të pengesave të të gjitha llojeve;.....*

d).....

dh).....

e).....

⁵ Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr.8137, datë 31.07.1996, hyrë në fuqi në datë 02.08.1996) dhe jurisprudenca e GJEDNJ janë të detyrueshme për tu zbatuar bazuar në nenin 116 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

⁶ Thlimmenos kundër Greqisë, Kërkesa nr. 34369/97, vendimi me datë 06.04.2000.

⁷ Ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 135, datë 28.08.2014 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit.

ë) realizimi progresiv, sipas të cilit Qeveria ndërmerr masa për të garantuar përfshirjen dhe aksesueshmërinë e të gjithë personave me aftësi të kufizuara në nivelin maksimal, që e lejojnë burimet e disponueshme, pa cenuar të drejtat e fituara, të cilat janë në përputhje me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”,

dhe të Ligjit 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 3 pika 7:

“Mohim i një përshtatjeje të arsyeshme” është ajo formë diskriminimi që ndodh kurdoherë kur ka një mohim ose kundërshtim për të kryer ndryshime ose rregullime të domosdoshme e të përshtatshme që nevojiten në një rast të veçantë dhe nuk imponojnë një barrë të tepruar, me qëllim që të sigurohet gëzimi dhe ushtrimi në baza të barabarta i të drejtave dhe lirive themelore për personat me aftësi të kufizuara, ose të ndodhur në kushtet e tjera të përmendura në nenin 1 të këtij ligji”,

Komisioneri gjykon se e drejta për mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e arsimit të nxënësve me aftësi të kufizuara, përfshin jo vetëm detyrimin e trajtimit të barabartë të tyre në situata të njëjta, por dhe trajtimin ndryshe, kur ata ndodhen në situata të ndryshme, çfarë nuk është parashikuar në Udhëzimin Nr. 14, datë 12.05.2015 i Ministrisë të Arsimit dhe Sportit. Për këtë arsye, Komisioneri vlerëson se akti nuk garanton aksesueshmërinë dhe mbrojtjen e të drejtave të fituara për këtë kategori nxënësish, për pasojë është diskriminues për ta.

Mbështetur në nenin 7, pika 1 e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ku parashikohet se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”, Komisioneri vlerëson se konkursi për nxënësin D.S. dhe dy nxënëset e tjera E. B. dhe Sh. S., që i përkasin grupit të personave me aftësi të kufizuara, për pranim në Liceun Artistik “Jordan Misja”, nuk ka patur si qëllim mënjanimin e pengesave dhe krijimin e kushteve për pranimin e tyre, por respektimin e një procedure formale të kërkuar nga institucionet përkatëse, në zbatim të Udhëzimit Nr. 14, datë 12.05.2015 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit. Pavarësisht faktit se një akt i nxjerrë nga organi kompetent është detyrim për t’u zbatuar nga institucionet e varësisë, së pari ai nuk mund të prevalojë mbi ligjin dhe së dyti, shkelja e ligjit e bën aktin të pazbatueshëm. Për pasojë mosveprimi nga ana e Drejtorisë së Liceut Artistik është bërë shkak për ekspozimin e nxënësit D.S. kundrejt diskriminimit, përmes zbatimit të një akti zyrtar, në shkelje të ligjeve të sipërcituara.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 1, 2, 3, pika 1 dhe pika 7, nenin 4/2, neni 6/2, neni 7/1, nenin 20, nenin 32, pika 1, gërma b), nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e diskriminimit të nxënësit D.S., për shkak të aftësisë së kufizuar, përmes aktit, Udhëzim nr. 14, datë 12.05.2015, *“Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pranimin në shkollat e arsimit të orientuar”*, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
2. Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, rekomandimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për shtrirjen e dispozitave të Udhëzimit nr. 14, datë 12.05.2015, *“Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pranimin në shkollat e arsimit të orientuar”*, në përputhje dhe zbatim të ligjit 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe të ligjit 93/2014 *“Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”*, duke i dhënë hapësirë trajtimit të ndryshëm dhe përshtatjes së arsyeshme të kushteve për konkurrim për kategorinë e nxënësve me aftësi të kufizuara.
3. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2011, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Ministria e Arsimit dhe Sportit, brenda 30 ditëve të informojë Komisionerin, në lidhje me zbatimin e pikës 2 të këtij vendimi.
4. Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa konkrete nga ana drejtorisë së Liceut Artistik “Jordan Misja”, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, që për vitin e ardhshëm akademik, konkursi i pranimi të nxënësve me aftësi të kufizuara të bëhet në përputhje të plotë me dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe të ligjit 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”, duke krijuar kushte për trajtim të diferencuar të tyre.
5. Mbështetur në dispozitat e nenin 33, pika 11 të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2011, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.

6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, brenda afateve të parashikuara me ligj.

KOMISIONERI

IRMA BARAKU

Shkak – aftësi e kufizuar

Fusha – arsim

Lloji i vendimit- diskriminim